



**VENDIM**

**Nr.49, Datë 31.03.2017**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË LIÇENSIMIT TË SHOQËRISË  
“ENERGJI UNIVERS” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2 gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të neneve 4 pika 1 gërma “e”; 5 pika 1 gërma “e” dhe 10 pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.03.2017, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për licensimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

- ERE me vendimin nr.20, datë 31.01.2017, vendosi mos-fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike për mangësi në dokumentacionin e aplikimit.
- Në vijim të sa më sipër shoqëria “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k ka hapur në QKB çështjen me nr. CN-161093-02-17, datë 17.02.2017, e cila ka lidhje me depozitimin e vendimit të asamblesë datë 09.02.2017, duke përfshirë në objekt të veprimtarisë së saj, tregtimin e energjisë elektrike.
- Shoqëria “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, ka paraqitur në ERE me shkresën nr. 119/4, datë 28.02.2017, Formatin e aplikimit, Ekstratin e QKB, si dhe një deklaratë e cila shpreh se vendos në dispozicion të aktivitetit të Tregtimit të Energjisë Elektrike shumën 25.000 Euro në llogarinë e saj bankare në Raiffeissen Bank.
- Aplikimi i shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregullores për procedurat dhe afatet për

*dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike si më poshtë:*

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) janë paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licensimin e shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**

**Petrit AHMETI**

